



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1397/5 prot.

Datë 27.06.2025

V E N D I M
Nr.831/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.06.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-41185-03-14-2025, me objekt “Loti 7: “Regjistrim fillestar i pasurisë për Bashkitë: “Elbasan, Krujë”” me fond limit në vlerën 44,295,300 (dyzet e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa tvsh, ose 445,492.31 (katërqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy pikë tridhjetë e një) euro pa tvsh, zhvilluar në datën 17-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Ankimues:

BOE “GEO CONSULTING” SHPK me NUIS K31421004D & “Geo-sky” sh.p.k. me NUIS K61615017N & OE “INVENT” sh.p.k. me NUIS L32015008T & OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS sh.p.k. me NUIS K61814023M & OE “Bujar Karanxha” p.f me NUIS L52423025R dhe adresë Rruga Reshit Çollaku, Pallati 23/1, shk. 1, ap. 3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara
Rr. "Reshit Çollaku", godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së
Lartë), Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për
miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndryshuar,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë
13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe
funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i
Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë
5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për
Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të
Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga
COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim
e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e
ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje
me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe Rregullat
e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye
legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe
njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në
ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor
dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18-03-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-41185-03-14-2025, me objekt “Loti 7: “Regjistrim fillestar i pasurisë për Bashkitë: “Elbasan, Krujë”” me fond limit **në vlerën 44,295,300 (dyzet e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa tvsh, ose 445,492.31 (katërqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy pikë tridhjetë e një) euro pa tvsh**, zhvilluar në datën 17-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 17.04.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 21.05.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “GEO CONSULTING” SHPK & “Geo-sky” sh.p.k. & OE “INVENT” sh.p.k. & OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS sh.p.k. & OE “Bujar Karanxha” p.f 33,417,000 lekë pa TVSH skualifikuar
2. BOE “CIVIL CONS” sh.p.k. & “EC Pro Partners” sh.p.k & “GRAMA” sh.p.k 34,839,000 lekë pa TVSH skualifikuar
3. BOE “ARENA MK” SHPK & “HTS COMPANY” sh.p.k & “HP-Surveying” sh.p.k 36,545,400 lekë pa TVSH kualifikuar
4. BOE “SRP ALBANIAN ENGINEERING” sh.p.k & “DECAGON” sh.p.k & “MCE” sh.p.k 36,972,000 lekë pa TVSH skualifikuar
5. BOE “LORENCO & CO” sh.p.k & “GURABARDHI & B ZH PARTNERS” & “VIANTE Konstruktion” sh.p.k & “E.B.S” sh.p.k & “LACONICS” sh.p.k. 37,825,200 lekë pa TVSH kualifikuar
6. BOE “DERBI-E” sh.p.k & “S - MYFTARI & PARTNERS” sh.p.k & “Geo&Land” sh.p.k. 38,536,911 lekë pa TVSH skualifikuar

II.4. Në datën 26.05.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

II.5. Në datën 30.05.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1397/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5359 i bashkimit të operatorëve ekonomik “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Consulting” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-41185-03-14-2025, me objekt “Loti 7: “Regjistrim fillestar i pasurisë për Bashkitë: “Elbasan, Krujë”” me fond limit 44,295,300.00lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur

nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Consulting” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1397/1 prot., datë 02.06.2025, duke publikuar arsyet e skualifikimit të BOE “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Consulting” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK.

si vijon:

“[...]

Operatori Ekonomik me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme: A. BOE nuk plotëson pikën 1/a të “Kritereve të vecanta të kualifikimit” në të cilën përcaktohet: Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10. Anetari I BOE ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS shpk ka paraqitur formularin e pandryshuar të vetëdeklarimit duke mos deklaruar përcaktimet sipas nenit 26 të VKM 285/2021 e ndryshuar. Perkatesisht pika “OE nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në perfundimin e kësaj kontrate” dhe “operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi si dhe deklaroi se është konsultuar me operator të tjerë në përparim të ofertës. Të gjithë anëtarët e boe nuk kanë plotësuar saktë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 pasi nuk kanë deklaruar në seksionin përkatës B. Deklaratë (Informacionin mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik) asnjë nga subjektet mbështetëse në këtë procedurë. B. BOE nuk plotëson pikën 1/b të “Kritereve të vecanta të kualifikimit” në të cilën përcaktohet: Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Sigurimi i ofertës i paraqitur nga BOE është vetëm në emër të shoqërisë kryesuese të BOE-s në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 88 RRPP e cila përcakton: 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Nga sa më lartë BOE skualifikohet për mosplotësim të kërkesave të vecanta për kualifikim.

II.7. Me shkresën me nr. 1723/11 prot., datë 10.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1397/2 prot., datë 11.06.2025, me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Geo Consulting” SHPK & “Illyrian Consulting Engineers” shpk &

“Bujar Karanxha” pf lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-41185-03-14-2025, me objekt: Loti 7 “Regjistrim fillestar i pasurisë për Bashkitë: “Elbasan, krujë”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues nga ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimin e BOE “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit: “[...]Operatori Ekonomik me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme: A. BOE nuk plotëson pikën 1/a të “Kritereve të vecanta të kualifikimit” në të cilën përcaktohet: Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10. Anetari I BOE ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS shpk ka paraqitur formularin e pandryshuar të vetëdeklarimit duke mos deklaruar përcaktimet sipas nenit 26 të VKM 285/2021 e ndryshuar. Perkatesisht pika “OE nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të meparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në perfundimin e kësaj kontrate” dhe “operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi si dhe deklaroi se është konsultuar me operator të tjerë në përparim të ofertës. Të gjithë anëtarët e boe nuk kanë plotësuar saktë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 pasi nuk kanë deklaruar në seksionin përkatës B. Deklaratë (Informacionin mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik) asnjë nga subjektet mbështetëse në këtë procedurë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën nr.9, Loti 7 “REGJISTRIM FILLESTAR I PASURISË PËR BASHKITË: “ELBASAN, KRUIË”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1 (a) “autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

III.1.2. Në shtojcën nr.10, “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT****Deklarata**

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

<i>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</i> <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>			
<i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i> <i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i> <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>			
<i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i> <i>Sqarime _____ nëse _____ vlerësohet _____ e</i> <i>nevojshme _____</i>			

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijsëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th.

bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e	Po [] Jo []

ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
---	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me fazë, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

- ***Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.***
- ***Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.***
- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomik “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK ka paraqitur:

- Akt marrëveshje për bashkëpunim të përkohëshëm mes palëve me nr. Repertori ***, nr. Koleksioni ***, datë 16.04.2025, lidhur ndërmjet shoqërisë “Geo Consulting” shpk dhe shoqërisë “Geo-sky” shpk dhe shoqërisë “INVENT” shpk dhe shoqërisë “Illyrian Consulting Engineers” shpk dhe subjektit “Bujar Karanxha” pf
- Prokurë e posaçme me nr. Repertori ***, nr. Koleksioni ***, datë 16.04.2025 me anë të së cilës të përfaqësuarit: “Geo-sky” shpk, shoqëria “INVENT” shpk, shoqëria “Illyrian Consulting Engineers” shpk dhe subjektit “Bujar Karanxha” pf emërojnë përfaqësues të posaçëm shoqërinë “Geo Consulting” shpk.
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të plotësuar nga operatori ekonomik “Bujar Karanxha” p.f të firmosur dhe vulosur;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të plotësuar nga operatori ekonomik Geo Consulting” shpk të firmosur dhe vulosur;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të plotësuar nga operatori ekonomik “Geo-sky” shpk të firmosur dhe vulosur;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të plotësuar nga operatori ekonomik “INVENT” shpk të firmosur dhe vulosur;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të plotësuar nga operatori ekonomik Illyrian Consulting Engineers” shpk të firmosur dhe vulosur;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi plotësuar nga operatori ekonomik “Romeo Nazarko” pf ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik ka deklaruar se: *“Mbështetës me licensë active në projektim të kategorisë 8a – rilevime inxhinierike/8b-Rilevime Inxhinierike Kadastrale/8c-Sisteme GIS/8d-Bazamente Gjeodezike/8e-Projektim fotogrametrik dhe hartografik”* ;
- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit plotësuar nga operatori ekonomik “Kostandin Qirjazi” pf ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik ka deklaruar se: deklaroi se: *“...Mbështetës me licensë active në projektim të kategorisë 8a- Rilevime inxhinierike/8b-Rilevime inxhinierike kadastrale/8c-sisteme GIS/8d-Bazamente Gjeodezike/8e-projektim fotogrametrik dhe hartografik”.*

- Formular përmbledhës vetëdeklarimi plotësuar nga operatori ekonomik “Angerba” shpk ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik ka deklaruar se: deklaron se: *‘Mbështetës me licensë active në projektim të kategorisë 8a-Rilevime inxhinierike/8b-rilevime inxhinierike kadastrale/8c-isteme GIS/8d-bazamente gjeodezike/8e-Projektim fotogrametrik dhe hartografik’*.
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “Rajmond Dervishi” pf ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik deklaron se: *“Mbështetës me profesion Jurist”*.
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “10AE” SHPK ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik deklaron se: *“Mbështetës me profesion jurist”*.
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “Atmir Mani” pf ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik deklaron se: *“Mbështetës me profesion jurist”*.
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “Artemis Braja” pf ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik deklaron se: *“Mbështetës me profesion IT”*.
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “Klaudia Toçi” pf ku në seksionin A. Pjesa I: Informacion në lidhje me operatorin ekonomik deklaron se: *“Mbështetës me profesion Jurist”*.

III.1.4. Në pikën 1 të nenit 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij. 2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur: a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi; b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja

detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh; ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkëljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë; b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji; c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi. ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën; d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja; e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit; f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin. g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik 51 të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

III.1.5. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...

III.1.6. Në nenin 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij . Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.8. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të

provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. 3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër. 4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës. 5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, 19 atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. 6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit. 7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Nisur nga arsyeja e skualifikimit se “...A. BOE nuk plotëson pikën 1/a të “Kritereve të vecanta të kualifikimit” në të cilën përcaktohet: Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10. Anetari I BOE ILLYRIAN CONSULTING ENGEENERS shpk ka paraqitur formularin e pandryshuar të vetëdeklarimit duke mos deklaruar përcaktimet sipas nenit 26 të VKM 285/2021 e ndryshuar. Perkatesisht pika “OE nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri

thelbesor te nje kontrate te meparshme me nje autoritet ose ent kontraktor apo nje kontrate koncesionare qe ka cuar ne perfundimin e kesaj kontrate” dhe “operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi si dhe deklarën se është konsultuar me operator te tjere ne pergatitjen e ofertes:, si dhe lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK me arsyetimin, se “.....Konkretisht: A. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit. Argumentimi: BOE ka plotësuar qartë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke deklaruar në mënyrë të detajuar të gjitha elementet e kërkuara sipas dokumenteve standarde të procedurës. I vetmi ndryshim është përdorimi i versionit të mëparshëm të formularit, i cili nuk përmban ndryshime në përmbajtje dhe nuk ndikon mbi faktet apo gjendjen juridike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë..... I gjithë komunikimi I BOE pjesmarres ne procedure ka qene korrekt sipas te gjitha kerkesave qe kerkon ligji . Ne lidhje me AK komunikimi ka qene ne menyre elektronike ,duke respektuar integritetin e te dhenave dhe konfidencialitetin e ofertave ne menyre korrekte dhe te qarte . Per aq kohe sa oferta e paraqitur nga BO eshte ne perputhje me fondin limit dhe nuk eshte klasifikuar si oferte anomalisht e ulet , argumenti se nje prej operatoreve eshte konsultuar me operator te tjere ne pergatitjen e ofertes rezulton I pavertete dhe nul “, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit të pikës 2.1 (a) të shtojcës 9 të dokumentave të tenderit, si dhe shtojcës 10 Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit BOE “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK ka ngarkuar në SPE dokumentacionin e listuar në pikën III 1.3 të këtij vendimi. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar konkretisht Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” SHPK pjesë e BOE, KPP konstaton, se operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” SHPK nuk ka plotësuar sipas shtojcave të reja të ndryshuara nga APP formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe konkretisht Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A. Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, përkatesisht pika ku operatori ekonomik deklarën se:

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Si dhe pika ku operatori ekonomik deklarën se “operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu rezulton se nuk është plotësuar në përputhje me dokumentat e tenderit shtojca 10 seksioni B: Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura.

Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, si dhe dokumentave të tenderit të publikuara nga autoriteti kontraktor (sipas dokumentave standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik me njoftim nr. 6571 prot., datë 23.09.2024) Komisioni gjykon, se Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit nuk është plotësuar saktë nga ana e operatorit ekonomik

“Illyrian Consulting Engineers” SHPK në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik, si dhe dokumentat e tenderit. Si rrjedhojë pretendimi i BOE “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit se: *“Të gjithë anëtarët e boe nuk kane plotësuar sakte Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 pasi nuk kane deklaruar ne seksionin perkates B. Deklaratë (Informacionin mbi subjektet mbi kapacitetin e te cilëve do të mbështetet operatori ekonomik) asnjë nga subjektet mbeshtetese në këtë procedurë”,* Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga verifikimi në SPE rezulton se ndër të tjera BOE ka ngarkuar në SPE formular përmbledhës vetëdeklarimi të plotësuar nga subjektet mbështetëse të listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi. Ndërkohë referuar formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE nga operatorët anëtarë të BOE konkretisht formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga operatori ekonomik Geo Consulting SHPK, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Invent” SHPK, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Geo Consulting” SHPK, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur plotësuar nga operatori ekonomik Bujar Karanxha pf, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të plotësuar nga operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” SHPK, KPP konstaton, se këto të fundit kanë paraqitur Formular përmbledhës vetëdeklarimi të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesën I, pika B, nuk është dhënë informacion mbi subjektin dhe mbi kapacitetin, e të cilit do të mbështetet secili prej operatorëve anëtar i BOE ankimes. Konkretisht nga verifikimi i formularëve të dorëzuar nga secili prej anëtarëve të BOE rezulton se nuk është plotësuar seksioni B: DEKLARATË Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme) me të dhëna të operatorëve ekonomik mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet.

III.2.1 Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga

autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Neni 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se, për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit "Për Prokurimin Publik", nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 10 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", në pjesën e fundit përcaktohet, se, **"Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës"**. Në rastin konkret BOE ka ngarkuar në SPE Formular Përmbledhës vetëdeklarimi të subjekteve mbi kapacitete e të cilëve do të mbështetet, por vetë anëtarët e BOE ofertues nuk kanë plotësuar në mënyrë të saktë seksioni B: DEKLARATË Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme), duke mos deklaruar subjektet mbështetës.

Akoma më tej Komisioni thekson se referuar ankesës me nr. 1397 prot, datë 02.06.2025 administruar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, BOE ankimues nuk ka argumentuar dhe nuk ka ngritur pretendime të qarta lidhur me këtë arsye skualifikimi. KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimin e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave mbështet pretendimet e tij për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i BOE "Geo Consulting" SHPK & "Invent" SHPK & "Geo Sky" SHPK & "Bujar Karanxha" PF & "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" SHPK ankimues nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e BOE "Geo Consulting" SHPK & "Invent" SHPK & "Geo Sky" SHPK & "Bujar Karanxha" PF & "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit se: *"B.BOE nuk plotëson pikën 1/b të "Kritereve të vecanta të kualifikimit" në të cilën përcaktohet: Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Sigurimi i ofertës i paraqitur nga BOE është vetëm në emër të shoqërisë kryesuese të BOE-s në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 88 RRPP e cila përcakton: 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë*

bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Nga sa më lartë BOE skualifikohet për mosplotësim të kërkesave të veçanta për kualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën nr.9, Loti 7 “REGJISTRIM FILLESTAR I PASURISË PËR BASHKITË: “ELBASAN, KRUIJË”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1 (b) autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

III.3.1. Në shtojcën nr.3 Loti 7 “REGJISTRIM FILLESTAR I PASURISË PËR BASHKITË: “ELBASAN, KRUIJË”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1 (b) “autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 3.

[Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë

prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.3.2. Në Seksionin 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes, afatin dhe vlerën e sigurimit të ofertës, si më poshtë:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **8,213,585 (tetë milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë, ose 82,606.71 (tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtë pikë shtatëdhjetë e një) euro.**

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

..... Loti 7: 885,906 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë ose 8,909.85 (tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë tetëdhjetë e pesë) euro.

3.1.2 Autoriteti/ Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor:

Credins Bank

SËIFT:CDISALTRXXX

NR.LLOGARIE: 00002032030

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare *X*

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente *X*

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 DITË (shprehur në ditë)

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimes në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- BOE ka paraqitur: Formular i Sigurimit të Ofertës nr. i serisë: 254111093, ReF:41185-03-14-2025, datë 17/04/2025 për Operatorin e Blerjeve të Përqëndruara AL, në emër të Geo Consulting, NIPT K31421004D”, procedura e prokurimit (nëse zbatohet): E hapur mbi kufirin e lartë monetar, përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti 7:Regjistrim fillestar i pasurisë për Bashkitë: “Elbasan, Krujë”, me përmbajtje: “*Duke iu referuar procedurës së lartëpërmendur ne Sigal Uniqua Group Austria Sha, Tiranë jemi garantues të Geo Consulting, Nipt K31421004D për një vlerë prej 885,906.00 lekë (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nentëqind e gjashtë lekë) si kusht për sigurimin e ofertës të dorëzuar nga ky operator.Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës, që është 150 ditë që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave*”.

III.3.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një

organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.5. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së

sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

- i. në formën e garancisë bankare; ose*
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”.*

III.3.6. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.”.

III.3.7. Në neni 88, pika 2 Bashkimi I operatorëve ekonomikë” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.”

III.3.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.1.b të Shtojcës 9/2 të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve të ligjore të sipërpërmendura meqenëse vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ka përcaktuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit, sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 të këtyre dokumenteve, si dhe sipas përcaktimeve në pikat 3, 3.1.2 dhe 3.2 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” autoriteti kontraktor ka përcaktuar format alternative të paraqitjes së sigurimit të ofertës, ku njëra është në formën e garancisë bankare ose tjetra nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe vlerën e sigurimit prej **885,906 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë ose 8,909.85 (tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë tetëdhjetë e pesë) euro.**, si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej 150 ditë.

III.3.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre,

ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se referuar “Formularit të sigurimit të ofertës” të dorëzuar nga BOE ankimues është lëshuar në njërin prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

Nga verifikimi i “Formularit të sigurimit të ofertës”, pra sigurimit të ofertës të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik, konstatohet, se ky i fundit është lëshuar në njërin prej formave të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik, konkretisht nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente, gjithashtu konstatohet se ky dokument bankar përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në shtojcën 3 “Formulari i sigurimit të ofertës” të dokumentave të tenderit, përsa i përket periudha e vlefshmërisë për të cilën është i vlefshëm ky sigurim, si dhe vlerës monetare të sigurimit të ofertës.

Nisur nga arsyetja e skuallifikimit të BOE ankimues Komisioni konstaton, se në formularin e sigurimit të ofertës të ngarkuar në SPE nga BOE përcaktohet se: “....Ne Sigal Uniqa Group Austria ShA, Tiranë jemi garantues të “Geo Consulting, NIPT K31421004D” për një vlerë prej 885,906.00 lekë (tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtë lekë) si kusht për sigurimin e ofertës të dorëzuar nga ky operator....”. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. **Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë**”, si dhe referuar formularit të sigurimit të ofertës Komisioni thekson, se në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar qartësisht që në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve duhet të specifikojë pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Referuar formularit të sigurimit të ofertës me nr. serie 254111093 të ngarkuar në SPE rezulton se përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë sipas prokurës me nr.repertori 1904 dhe nr. koleksioni 978 pra operatori ekonomik “Geo Consulting” SHPK nuk ka specifikuar në formular pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Akoma më tej Komisioni thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të gjithë operatorët ekonomikë duhet të jenë në kushte të barabarta si kur pregatisin ofertat e tyre ashtu edhe kur bëhet vlerësimi i tyre. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson pikën 2.1 (b) të shtojcës 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-41185-03-14-2025, me objekt “Loti 7: “Regjistrim fillestar i pasurisë për Bashkitë: “Elbasan, Krujë”” me fond limit **në vlerën 44,295,300 (dyzet e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa tvsh, ose 445,492.31 (katërqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy pikë tridhjetë e një) euro pa tvsh,** zhvilluar në datën 17-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “Geo Consulting” SHPK & “Invent” SHPK & “Geo Sky” SHPK & “Bujar Karanxha” PF & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri